

SHOQËRIA TREGTARE ME ORTAKËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR

Eagle Invest SH.P.K

S T A T U T

KREU I:

EMERTIMI - OBJEKTI - SELIA - KOHËZGJATJA

NENI 1

Në Tiranë ,sot me datën 28/06/2023,(dymijë e njëzet e tre) ditë e Mërkurë,
shtetasi me këtë identitet:

Z. ABDURRAHMAN ZEKAJ , atësia **RAMIZ** , Mëmësia **NDRIÇIME** i
datëlindjes 14.10.1999, shtetas shqiptare , lindur në Tiranë dhe banuese në
Tiranë, identiteti i të cilit verifikohet me Pasaporten me numër BC3004440, me
Nr. ID J91014050K me afat deri më 07/02/2026 ,

krijoi:

Shoqërinë Tregtare me ortakëri dhe me përgjegjësi të kufizuar

Eagle Invest SH.P.K ,Tiranë – Albania.

NENI 2

Selia Qëndrore e Shoqërisë është në adresën: Tiranë ,Rruga Elbasanit,
Hyrja 1, Ap. 3, Objekt me Nr. Pasurie 5/112 +1-3, Zona Kadastrale 8160.

NENI 3



Shoqëria e shtrin aktivitetin tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

Njësitë e tjera strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është në likuditet në shumën **1.000.000 Lekë** (njëmilion lek) i ndarë në **1 kuotë** te formuara dhe nënshkruar nga Ortakët sipas këtij kontributi:

- 1. Ortaku Z. Abdurrahman ZEKAJ** kontribues me shumën **1.000.000 Lekë** e barabartë me **1 kuotë me të drejtë vendimore, e barabartë me 100 %**.

Ortakët kanë pavarësi ligjore ,organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjetër (të luajtshme apo të paluajtshme), të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj .

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e tyre ,përfshirë fondet dhe vlerat e kontributit në natyrë bazuar në të drejtën që u njeh Ligji **“Për Investimet e Huaja “**.

Shoqëria dhe të tretët ,respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë.

NENI 6

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT** , duke filluar ky afat nga dita e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshoj dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës kompetente për të bërë shënimet e nevojshme në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e Kontratës së Themelimit dhe këtij Statuti të saj.

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këtë Drejtim:

Veprimtari ekonomike ne fushën e Real Estate (pasurive te paluajtshme), qe ka te bej me negocime, ndërmjetësime, përfaqësime të të tretëve në fushën e Real Estate si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Shitje, blerje, dhënie dhe marrje me qira e pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo transaksion tjetër ne funksion te përmbushjes se objektit te veprimtarisë ne fushën e Real Estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm qe ka te beje me pasuritë e paluajtshme. Marrja dhe/ose zhvillimi, kryerja ose ofrimi i shërbimeve në fushën e Real Estate (pasurive të paluajtshme), që kane te bëjnë me marketing dixhital apo fizik, marrëdhëniet me publikun, ekspertize shitje apo qiradhënie apo operim/administrim turistik, menaxhimi i pasurive te patundshme, shërbime të studimit te tregut, shërbime te pas shitjes, ndjekja e pagesave te klientëve. Vlerësimi i te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme (urbane, rurale, komerciale, administrative, shoqërore, turistike, rezidenciale etj.) dhe asetëve (te luajtshme apo te paluajtshme) ne funksionet e tyre; Administrimi i bashkëpronësisë ne ndërtesa, ne resorte apo struktura turistike dhe ne komplekse rezidenciale. Operacione që lidhen me pasuri të paluajtshme/luajtshme, të blejë e të shesë, marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri tregtare, ente, konsorciume, shoqëri të thjeshta, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të ngjashëm me shoqërinë, të japë garanci, dorëzani, të marrë hua dhe ofrojë garanci pasurore në favor të të



tretëve të jetë palë dhe të ofrojë shërbime, produkte, nëpërmjet të gjitha formave të kontraktimit apo prokurimit publik, marrëveshjeve apo tratativave tregtare apo/dhe me karakter civil, etj. Studio projektimi, projektim arkitektonik, inxhinierik, elektrik, hidraulik, statik, panele diellore, studime urbanistike, projektim vepra inxhinierike dhe arti, ndërtime civile dhe industriale, banesa, vepra të karakterit ndërtimor me konstruksion betoni apo hekuri, marrja e përfaqësisë dhe menaxhimit në fushën e ndërtimit, projektim dhe zbatim dhe supervizim punimesh ndërtimi në funksion të investimit të kompanisë ose një investitori të tretë, dizejm urbanistik, konsultim në aktivitetet e ndërtimit, gërmime dheu, izolime, instalim impiante elektrike dhe hidraulike, restaurime dhe mirëmbajtje të pasurive të paluajtshme në pronësi apo të marra nën kujdes, impiante teknologjike, vepra të inxhinierisë së natyrës, aparatura strukturore speciale, struktura të parafabrikuara prej betoni, komponentë strukturore me përbërje hekuri dhe metali, matje topografike, asgjësimi i veprave të ndryshme, gjelbërim dhe rregullim territori, ndërtim të dyshemesë dhe strukturave speciale të sipërme, sisteme kundra zhurmës për infrastrukturën e pajisjeve të lëvizshme, rikonstruktime, lotizime, prodhim materiale të ndërtimit dhe të gjitha nëndegëzimet (si materiale hidraulike, elektrike, rifiniturave beton etj.) dhe tregtimi i tyre, marrja e liçensave të ndryshme në çdo aktivitet të ndërtimit apo lëndës së ndërtimit, import-eksport i materiale të ndërtimit, mjeteve motorike të rënda apo të lehta të përdorshme në ndërtim apo në industri të tjera të biznesit, pjesë këmbimi për to, makineri të përdorshme në ndërtim dhe tregtimi apo dhënia me qera apo tituj të tjerë tek të tretët, shërbimi i mirëmbajtjes dhe pjesë këmbimi për këto mjete motorike dhe makineri, materialeve të ndërtimit, mallrave të përgjithshme pa kufizim që kërkohen në tregun e lirë, makineri pajisje të përdorshme në industrinë e ndërtimit, biznese profesionale mbështetëse, biznese shërbimi (bare, restorante, hotele), materiale elektroshtëpiake, mallrave dhe sendeve që kërkohen në treg dhe ku shoqëria parapëlqen të investojë dhe ushtrijë veprimtari tregtare, shitblerje, depozitim dhe marrje të përfaqësisë për materiale, makineri dhe prodhime të tjera në përgjithësi të lidhura me industrinë e ndërtimit, e pajisjeve industriale dhe të ngjashme me to, zhvillimi i aktivitetit të turizmit në çdo fushë, promovimi, shfrytëzimi i kapacitetit turistik dhe argëtues, agjensi komisionere, punësimi, transporti të çdo lloji për interesin e vet apo të të tretëve, spedicioni, administrimi dhe aktivitet tregtar në gamën e shërbimeve bare-restorante-hotele. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake,



elektronike, sistemeve/impianeteve termike, te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mire menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, te telekomunikacionit si dhe impianteve te tjera te ngjashme te destinuar per objekte civile dhe industriale, për sektorë të ndryshme.

NENI 9

Me qëllim arritjen e objektivit të shoqërisë , ajo ka të drejtë të merret me gjithçka që ka lidhje me objektin e saj , duke përbushur të gjitha veprimet tregtare ,për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme ,financiare e bankare , edhe me veprime të zbuluara (përfshirë mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesëmarrjen në fitim si dhe marrjen pjesë në shoqëri të tjera dhe sipërmarrje me objekt veprimtarie analog,të ngjashme ose të lidhur me të , qofte direkt ,qoftë indirekt.

NENI 10

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e pajisjes me Çertifikatën e Identifikimit të personit të Tatuashem (NIPT)nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit .

KREU II :

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria çel Llogari Bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Çdo Ortak si dhe **Administratori Përgjithshëm** i caktuar në Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, depoziton specimentin e firmës origjinale në bankat ku është çelur llogaria dhe veprimet bankare kryhen me firmën e secilit ortak për veprimtarinë e zakonshme financiare ,kryerjen e pagesave, likudimeve



me furnitorët jashtë e brenda vendit të detyrimeve fiskale shtetërore si tatimore, doganore, sigurimeve Shoqërore e shëndetësore, TVSH.

Ndërsa në rastet e kryerjes së **veprimtarive të rëndësishme** që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe të jashtëzakonshme, që lidhen me transaksione që kanë të bëjnë me blerje të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo cdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit në likuiditet apo në natyrë, vënie garancie hipotekore apo bankare, ato për çelje dhe marrje kredie, për marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombëtare, Administratori i Përgjithshëm **i emëruar** kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e **Vendimit me shkrim** të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

NENI 12

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë, emërohet **Z. Abdurrahman ZEKAJ** atësia **Ramiz**, e datëlindjes 14.10.1999, dhe

Bazuar në **nenin 95 të Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008** "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori i Përgjithshëm **Z. Abdurrahman ZEKAJ** dhe emërohet për një **periudhe kohe 5 vjet**, me të drejtë ripërtëritje.

NENI 13

Pjesët e Kapitalit Themelor, janë në likuiditet, nominative dhe lirisht të transferueshme në mes ortakëve dhe rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave ndaj njëri tjetrit.

Ata gëzojnë gjithashtu të drejtën e shitjes apo transferimit të kuotave që zotërojnë, persona të tjerë fizik apo juridik, jashtë ortakërisë, vendas ose të huaj, vetëm atëherë kur asnjëri prej tyre nuk ushtron të drejtën e parablerjes.

Shitja apo transferimi i kuotave tek ortakët dhe të tretët bëhet me akt noterial.



NENI 14

Për tjetërsimin e kuotave në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar, secili ortak është i detyruar të njoftoj me shkrim Shoqërinë, e cila brenda **3** (tre) muajve nga dita e njoftimit, duhet të marrë vendim me shkrim për lejimin e transferimit. Ky vendim merret me shumicën e votave "**Pro**", të Asamblesë së Ortakëve që zotërojnë pjesët e kapitalit themeltar.

Kur Asambleja e Ortakëve me kalimin e **90 ditëve** nuk merr vendimin përkatës për miratimin ose jo të kërkesës së njërit ortak për tjetërsimin e kuotave të tij, **kërkesa e tij quhet e pranuar**.

Kur në mbledhjen e saj Asambleja e ortakëve merr vendim për pranimin e kërkesës nga Ortaku që e ka bërë atë ka të drejtën e shitjes dhe transferimit të kuotave që ai zotëron.

Në rast se Asambleja e Ortakëve merr vendim për Refuzimin e Kërkesës për shitjen apo transferimin e kuotave, çdo Ortak brenda **90 ditëve**, duhet të ushtroj të drejtën e parablerjes së kuotave, në të kundërtën, me plotësimin e këtij afati, ortakë kërkues mund ti shesë apo transferojë kuotat e tij tek të tretët, brenda vendit apo jashtë shtetit.

Kur lind nevoja e vlerësimit të Kuotave, Ortakët marrin vendim me shkrim për caktimin e një Eksperti Kontabël të autorizuar dhe kur nuk bien dakord për një gjë të tillë, ja kërkojnë caktimin e tij Gjykatës së juridiksionit përkatës, vendimi i të cilës është i detyrueshëm, pasi të ketë marrë formën e prerë.

NENI 15

Ortakët, secili prej tyre, ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht Kontributet e tij përfshirë dhe Fondet e Kontributet në Natyrë bazuar në të drejtën që parashikon dhe lejon Ligji "Për Investimet e Huaja".

Transferimet e pjesëve të Kapitalit Themelor, duhet të jenë të vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë ortakët duhet të marrin paraprakisht Vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 16



Kapitali Themeltar i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e Vendimit me shkrim të marrë unanimisht në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në rregjistrin përkatës.

Çdo Vendim i Ortakëve për ndryshimin e Kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë Qendrës kompetente që e ka njohur dhe rregjistruar Shoqërinë Person Juridik.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në dispozicion të Shoqërisë mund të vihen dhe fonde të tjera financiare duke përfshirë dhe shtesa me anë të Kapitalit në Natyrë.

NENI 17

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar, mbi bazën e Vendimit me shkrim të Asamblesë së Ortakëve, bëhet kur më parë secili Ortak ka deklaruar, nënshkruar dhe derdhur vullnetarisht pjesën e Kapitalit që kërkon të zmadhoj, si në formën e Kontributit në valute ose lekë dhe në natyrë.

Nuk konsiderohen zmadhim i Kapitalit themeltar, kontributet e shërbimeve të secilit ortak.

Pas marrjes së vendimit për zmadhimin e Kapitalit Themeltar, Ortakët duhet të marrin vendim me shkrim dhe për të pasqyruar një rrethanë të tillë në Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, duke pasqyruar qartë kuotat apo kontributin e derdhur nga secili Ortak.

NENI 18

Ashtu sikurse dhe në rastin e zmadhimit dhe kur bëhet **zvogëlimi i Kapitalit** Themeltar, merret Vendim me shkrim nga Mbledhja e Posaçme e Asamblesë së Ortakëve dhe zvogëlimi i Kapitalit themeltar e prek Ortakun në atë raport të pjesës së Kontributit që ai përfaqëson në krijimin e Kapitalit Themeltar.

Në rastin kur Asambleja e Ortakëve vendimin për Zvogëlimin e Kapitalit themeltar e merr për shkakun se humbjet e Shoqërisë arrijnë nën limitin e parashikuar dhe lejuar nga Kodi Tregtar për Shoqëritë me ortakëri me përgjegjësi të kufizuar, krahas vendimit për zvogëlimin e Kapitalit Themeltar, ortakët duhet të marrin Vendim dhe për të përcaktuar:



a. Nevojën e ndryshimit të formës juridike të Shoqërisë, duke kaluar në një formë tjetër.

b. Ndryshimin e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj.

c. Të bëjnë publikimin dhe njoftimin e të tretëve, me të cilët Shoqëria ka marrëdhënie kontraktore si dhe të kreditorëve të saj.

NENI 19

Si në rastin kur Ortakët, marrin Vendim me shkrim, për zmadhimin ose zvogëlimin e Kapitalit Themeltar, këto ndryshime duhen pasqyruar dhe në Aktin e Themelimit dhe në Statut dhe pasi të jenë legalizuar për bazueshmërinë ligjore dhe autenticitetin e nënshkrimeve para një NOTERI, dhe ato i dërgohen menjëherë për Depozitim QKR-se, për të bërë shënimet e nevojshme në Rregjistrin tregtar të Shoqërive Tregtare.

KREU III :

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 20

ORGANET DREJTUESE të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve (e zakonshme dhe e jashtëzakonshme).
2. Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

NENI 21

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, është Organi i vetëm më i lartë Drejtues e Vendimor i Shoqërisë dhe ushtron të gjitha kompetencat që i njeh Ligji "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" Asamblesë së Ortakëve që janë krijuar me Ortakëri.

Ortakët kryejnë Drejtimin dhe Administrimin e Shoqërisë, duke respektuar legjislacionin tregtar në Fuqi si dhe të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në Aktin e Themelimit dhe në këtë Statut.

Çdo Ortak mund t'ja delegoj Kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve, si dhe një

Personi fizik jashtë ortakërisë së Shoqërisë, shtetas shqiptar ose i huaj mbi bazën e prokurës, të bërë me akt noterial.

NENI 22

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose të bashkohet më një Shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit, të zgjeroj objektin e veprimtarisë së saj etj.

NENI 23

Ortakët e Shoqërisë kanë dhe këto të drejta dhe detyra kryesore:

* Të marrin pjesë në Drejtimin dhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të Shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

* Të kërkojnë dhe ti japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe i të gjitha dokumentave të përpunuara nga shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit ekonomik të bilancit Kontabël apo për çdo llogarie të çelur, si të asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhse.

* Të marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në çfarëdo forme apo sasi, sipas kontributit të dhënë prej tij.

* Të kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

* Me Vendim të Asamblesë, Ortakët emërojnë dhe shkarkojnë në çdo kohë Administratorin e Shoqërisë, si dhe Ekspertin Kontabël të autorizuar.

* **Secili Ortak** me anë të Administratorit brenda ortakërisë ose të atij të emëruar prej tyre jashtë ortakërisë dhe kur ky i fundit është i pajisur me prokurë, ushtrojnë dhe këto Tagra (të Drejta):

Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen së janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jenë:

1. Të lidhin Kontrata të ndryshme që kanë për objekt Blerjen, shitjen, këmbimin dhe marrjen me qera të Pasurive të ndryshme (të luajtshme dhe të paluajtshme), atë të servitutit, uzufuktit Enfiteozes, Franchising, Sipërmarrje Ndërtimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo të Huaj, me

shtetin dhe në rastin e blerjes të Pasurive të Paluajtshme apo marrjen e tyre me qera për një kohe mbi 9 vjet, si dhe të Kontratave të Servitutit, Uzufuktit dhe Enfiteozes, duhet të bëjnë rregjistrimin Hipotekat e ZVRPP të rrethit të juridiksionit përkatës si për transkriptimin e Pronësisë në favor të Shoqërisë apo kalimin e kësaj pasurie në posedim ligjor.

Çdo blerje e pasurive të mësipërme, konsiderohet dhe si shtesë e Kapitalit në Natyrë.

2. Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha Zyrave shtetërore dhe Private, Bankat e çdo niveli etj, që kanë të bëjnë me garancitë, Sipërmarrjet, marrjen e Kredive, te Siguracioneve dhe Risiguracioneve për jeten dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashtë shtetit) kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara deklarimin e atyre të eksportuar, plotësimit në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

Në rastet kur Veprimet juridike kryhen nga Administratori i emëruar nga Ortakët ose personi që Perfaqëson njëri nga Ortakët mbi bazën e Prokurës, këta janë të detyruar që në përfundim të realizimit të veprimit përkatës të njoftojnë menjëherë dhe ti japin llogari Asamblesë së Ortakëve.

3. Administratori ose përfaqësuesi me Prokurë, janë individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë STATUT dhe për dëmin e shkaktuar me FAJ, sipas rastit, çdo Ortak mund të ngrej padi Civile dhe të kërkoj ndaj tyre shlyerjen e plotë të dëmit të shkaktuar, përfshirë dhe fitimin e munguar, duke patur njëkohësisht dhe të drejtën për të bërë kallzim për ndjekje penale në Prokurorin e juridiksionit tokësor përkatës.

NENI 24

Përfaqësimi i Shoqërisë, në mardhëniet me të tretët si brenda vendit dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht i përket secilit Administrator.

NENI 25



Çdo Ortak dhe Administratori i Shoqërisë, i emëruar prej Ortakëve kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të Shoqërisë, të marrin në punë specialiste dhe shtetas të ndryshëm madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke lidhur Kontratën sipas kritereve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi, të miratuar me Ligjin Nr.7961 dt. 12/07/1995 dhe shtesat e mëpasme plotësuese të tij dhe me Ligjin Nr.7703 dt.11/05/1993 "Për Sigurimet Shoqërore" si dhe në përputhje me rregullat teknike dhe të disiplinës profesionale të caktuara nga ana e punëdhënësit.

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

NENI 26

Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë, mbyllen me datën **31 Dhjetor** të çdo viti.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, bëhet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, nga data e mbylljes së vitit financiar.

Për nxjerrjen e rezultatit Kontabël të Shoqërisë, mbi bazën e Aktivit dhe Pasivit nga me vendim të Ortakëve caktohet një Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrolloj dhe verifikoj të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë Ekonomiko tregtare të Shoqërisë, si atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë mbi bazën e **Vendimit** të marrë nga Ortakët e Shoqërisë.

Në përfundim të Kontrollit, Eksperti kontabël i autorizuar përgatit Raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatatit përfundimtar të Bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë dhe dorëzoj në kohë Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, i cili është Organi i vetëm për ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 27



Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor, duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të sistemit të Tatim Taksave që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabël i autorizuar përveç të drejtave, ka dhe këto **detyrime**:

1. Garanton Asamblesë e Ortakëve së llogaritë vjetore janë të rregullta dhe Bilanci është nxjerrë me saktësi dhe konform rregullave të Ligjit "Mbi Kontabilitetin".

2. Të pasqyroj me vërtetësi rezultatet e operacioneve të vitit të kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare të Shoqërisë në mbylljen e vitit financiar të aktivitetit tregtar të saj.

3. Të verifikoj përputhjet me llogaritë vjetore të Informacioneve të dhëna nga Administratorët e Shoqërisë në Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, duke përfshirë dhe dokumentat për gjendjen financiare që ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblesë Ortakëve.

4. T'i bëjë të njohur Ortakëve dhe Administratorit të Shoqërisë:

Kontrollet dhe verifikimet që janë bërë prej tij për kontrole periodike ose vjetore, duke vënë në dukje parregullsitë apo pasaktësitë e konstatuar, masat ligjore për rregullimin e tyre etj.

NENI 28

Eksperti Kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj Shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme të shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar të Shoqërisë, por nuk është përgjegjës kur këto DËME shkaktohen pa dijeninë e tij dhe nga veprimet me faj të Administratorit të Shoqërisë.

NENI 29

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të marrë nga ortakët në mbledhjen e asamblesë së ortakëve, në të cilën jo vetëm që dokumentohet aprovimin e tij por dhe që përcakton dhe në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore, sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë por dhe për garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke patur parasysh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj

NENI 30



Për Formimin e fondit rezervë, që emertohet **“Rezervë e domosdoshme”** Ortakët vendosin që nga fitimi i akumuluar gjatë vitit financiar, pasi të zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, të lërë të paktën **1/20 e vlerës** së Fitimit të realizuar.

NENI 31

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj të tretëve, i kalojnë në pronësi, Ortakëve në raport me përqindjen e Kontributit financiar që ata kanë dhënë në krijimin e Kapitalit Themeltar.

NENI 32

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë, mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar Shoqëria siç mund të jenë:

a. Humbja e Kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga mënyrat e parashikuara nga Ligji “Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare”

c. Me kërkesën e njërit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Në këtë rast Ortakët, marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe lëshuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë **“Shoqëri në likuidim e sipër.”**

NENI 33

Akti i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në aneksin e rregjistrimit Tregtar.

NENI 34

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilave Shoqëria është Kreditore dhe



për ekzekutimin e plotë të detyrimeve (debtive) që Shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë, apo personave fizikë ose juridik vendas apo të huaj.

NENI 35

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht Ortakët duhet ta zgjidhin në mirëkuptim në të kundërtën çështjen mund ta bëjnë objekt Konflikti gjyqësor.

Të drejtën e ngritjes së Padisë gjyqësore, në rast konflikti civil, çdo Ortak e disponon në mënyrë të pavarur, duke e ngritur atë në **Gjykatën e rrethit Gjyqësor Durrës** ose në **Gjykatën ndërkombëtare të Parisit**.

NENI 36

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet udhëzimeve plotesuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga ana e Ortakëve të Shoqërisë si dhe hapsirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi dhe normave ndërkombëtare.

NENI 37

Ky Statut u redaktua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues të Shoqërisë tregtare **Eagle Invest SH.P.K.**

dhe nënshkruhet prej tij në të gjithë kopjet duke u vënë emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

TË SHOQËRISË TREGTARE ME ORTAKËRI **Eagle Invest SH.P.K.**



Miratues të këtij Statuti

z. Abdurrahman Zekaj 